



KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA
"EKOREGJIONI" SH.A. – PRIZREN
Zyra Regjionale

Adresa: Rruga "KUKSIT" nr 10
Tel: 029-241-167
Email: krm_ekoregjioni@yahoo.com
info@ekoregjioni.com

Prizren: 24.05.2023

Bazuar në kompetencat të cilat burojnë nga Statuti dhe Rregulloret e K.R.M. "Ekoregjioni" SH.a.Prizren, në bazë të Ligjit Nr.03/L-212, për Rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 4 paragrafi 6 dhe konform vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 23.05.2023,

SHPALLË këtë:

KONKURS


Për 3 vendë të lira pune (me kohë të caktuar në bazë të kontratave të komunës).

Puna Provuese 6 muaj

Vendi i punës :1 Inkasant në Njësinë Operative Dragash, 1 Puntorë Fizik në Njësinë Operative Rahovec dhe 1

Mirëmbajtëse në Njësinë Operative Prizren.

Detyrat dhe përgjegjësitë:



Inkasant

a)Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat sipas kontratës së punës, - Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht, -bën zbulimin- regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara dhe përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisëris respektivisht komercial duke e nojftuar Shërbimin e faturimit.(pergjegjesin) - Të gjitha paratë e inkasuara i dorëzon brenda dite, në bankën më të afërt apo sipas nevojës , në arkën kryesore të kompanisë, -kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga punëdhënësi sipas nevojës të procesit të punës në interes të ndërmarrjes.

Puntorë Fizik

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, - zbrazjen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre; - Sipas planit operativ dhe urdhëresës së punës bënë fshirjen-pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës; -Hapjen dhe mbylljen e varrit - Bën larjen e automjeteve - Bënë largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer; - Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve; - Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës; - Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit; - Për punën e kryer i përgjigjet Menaxherit të Njësisë dhe Kryepuntorit.

Mirëmbajtëse

- Kryen të gjitha punët e mirëmbajtjes preventive dhe vijuese të objekteve të Kompanisë, inventarin paisjet në objekte, - Gjatë sezonit dimëror angazhohet në mirëmbajtjen e nxemjes qendrore në funksion të sigurimit të ngrihjes normale të lokaleve të Kompanisë, dhe me kohë nderrmer veprimet e nevojshme në bashkëpunim me shërbimin teknik; - Mban higjienën dhe pastërtinë e lokaleve, korridoreve, toaleteve dhe hapsirës para ndërtesës së Kompanisë, në nivel të kënaqshëm; - Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë; - Bën heqjen e perdeve dhe dërgimin e tyre në pastrim kimik dhe rivendosjen e tyre, kontrollon mbylljen e lokaleve dhe dritave të zyreve pas kryerjes së ndrymit, zbraz dhe pastron shportat e mbeturinave, fshin pluhurat e mobileve, dyerve dhe dritareve dhe tepihat; - Kryen të gjitha punet e byfes, shërben punëtorët dhe mysafiret, kujdeset për gjendjen e higjienes dhe të artikujve në byfe; - Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë; - Për punë të tij i përgjigjet Menaxherit të Burimeve Njerzore dhe Juridike.



Kriteret e përgjithshme dhe procedura e vlersimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (provuese në kohë të caktuar dhe mvarësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevoja e kompanisë të njejtëve i rregullohet mardhënja e punës).

Procesi i vlersimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlersimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlersimit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopja e cërtifikatës së lindjes,
- Certifikatën shëndetësore sillet (pas konfirmimit të pranimit në punë)
- Certifikata penale nga Gjykata
- Kopje e diplomës të shkollës fillore, të mesme obligative për pozitën inkasnat etj.
- Dëshmi për përvojën e punës (trust etj/ nese posedon)
- Zarf me pozitën konkuresse dhe me numrin e telefonit /email adresë (për kontakt).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë dhe atë nga data 24.05.2023 deri më 08.06.2023, ora 16:00.

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet me zarf të mbyllur në protokolin e Kompanisë, (shënohet emri/ mbiemri/ pozita ne te cilen konkurron, nr.telefonit dhe email adresa) në adresën KRM "Ekoregjioni" SH.A. Rr. Kukesit nr. 10 në Prizren-kopjet e dorzuara nuk kthehen.Kandidatët të cilët i plotësojn kriteret, do të njoftohen me telefon/email për vendin dhe kohën e testit/ intervistës.

Konkursim mundë ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të K.R.M. "Ekoregjioni" Sh.a.Prizren, duke klikuar në: www.ekoregjioni.com.